

VENDIM
Nr. 217, datë 13.4.2022

**PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE TË REGJISTRIT ELEKTRONIK TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Regjistrit Elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të:

- a) pajisjeve matëse dhe kalibruese, që janë objekt i ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;
- b) autorizimeve për subjektet për të ushtruar veprimtari në zbatim të këtij ligji;
- c) autorizimeve për subjektet që bëjnë riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve matëse e kalibruese, në zbatim të këtij ligji;
- ç) subjekteve që zotërojnë dhe përdorin pajisje matëse, objekt i kontrollit metrologjik ligjor, sipas nenit 17, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;
- d) rezultateve të inspektimeve të kryera, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. Baza e të dhënave të Regjistrit Elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë administrohet e përditësohet periodikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), si institucioni administrues, sa herë është e nevojshme apo ka ndryshime të tyre, në kuptim të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”.

3. Regjistri Elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë shërben për:

- a) ndjekjen, monitorimin dhe vlerësimin e punës e të shërbimeve që ofron DPM-ja;
- b) ofrimin e përgjigjeve të kërkesave të bëra nga subjekte apo qytetarë;
- c) referimin për të marrë shërbimin ose informacionin e kërkuar në kohë të shpejtë;
- ç) unifikimin e kompjuterizimin e të dhënave të punës dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga regjistri;
- d) identifikimin e nevojave dhe hartimin e planeve përkatëse nga strukturat përgjegjëse.

4. Dhënës të informacionit në Regjistrin Elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë janë:

- a) laboratorët e autorizuar si mbajtës të etalonëve kombëtarë dhe sekondarë, sipas nenit 13, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;
- b) personat juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislationin në fuqi për të kryer shërbimet e parashikuara në ligjin nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;
- c) personat juridikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer verifikim periodik të instrumenteve në metrologjinë ligjore, sipas dispozitave të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;
- ç) personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer riparim të instrumenteve matëse.

5. Regjistri Elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përmban këto të dhëna parësore dhe dytësore:

5.1 Të dhënat parësore janë:

- a) të dhënat për pajisjet matëse dhe kalibruese, që janë objekt i ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;
- b) vendimet për autorizimet për subjektet për të ushtruar veprimtari në zbatim të këtij ligji;

c) vendimet për autorizimet për subjektet që bëjnë riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve matëse e kalibruese, në zbatim të këtij ligji;

ç) data e verifikimit/kalibrimit;

d) data e verifikimit të ardhshëm periodik;

dh) të dhënat e certifikatave dhe shenjave të konformitetit të lëshuara jashtë vendit, nëse ato janë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, sipas nenit 30, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;

e) të dhënat e paketuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti, sipas nenit 38, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”;

ë) laboratorët mbajtës të etalonëve kombëtarë të matjeve, sipas nenit 13, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”.

5.2 Të dhëna dytësore janë të dhënat e regjistrit tregtar për emrin, numrin unik të identifikimit, adresën dhe statusin për subjektet që zotërojnë dhe përdorin pajisje matëse, objekt i kontrollit metrologjik ligjor, sipas nenit 17, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”.

6. Niveli i aksesimit në Regjistrin Elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është, si më poshtë vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka akses si administratore dhe përdoruese e regjistrit. Niveli i aksesimit, funksionet e të drejtat për secilën kategori përdoruesi të sistemit janë në përputhje me pozicionin e punës së punonjësit të DPM-së;

b) dhënësit e informacionit, sipas pikës 4, të këtij vendimi, kanë akses si përdorues të regjistrit;

c) qytetarët, subjektet private dhe institucionet shtetërore kanë nivel aksesit si lexues të regjistrit.

7. Drejtori i Përgjithshëm i drejtorisë përgjegjëse për metrologjinë miraton rregulloren për organizimin e funksionimit të brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore, që krijohet nëpërmjet këtij vendimi.

8. Plotësimi i të dhënave parësore dhe dytësore në regjistrin elektronik nga strukturat përkatëse për plotësimin, administrimin duhet të ketë përfunduar brenda 1 (një) viti kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Administrimi teknik i infrastrukturës *hardware* dhe *software* të sistemit bëhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

10. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ruan konfidencialitetin dhe besueshmërinë e këtyre të dhënave personale, në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

11. Baza e të dhënave të Regjistrit Elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ndërvepron nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me bazën e të dhënave të regjistrit tregtar.

12. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama